

VENDIM
Nr. 891, datë 4.11.2015

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË
HASHEMITE TË JORDANISË, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E
PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë Hashemite të Jordanisë, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË MBRETËRISË HASHEMITE TË JORDANISË PËR HEQJEN E VIZAVE
PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Mbretërisë Hashemite e Jordanisë (më poshtë të referuara si “Palët Kontraktuese”);

duke dashur të lehtësojnë hyrjen, daljen dhe lëvizjen e qytetarëve të tyre, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shtetasit e të dyja Palëve Kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit, do të hyjnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese pa viza dhe do të qëndrojnë për një periudhë maksimale prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh brenda 180 ditëve nga dita e hyrjes, me kusht që ky qëndrim nuk do të përdoret për qëllime të angazhimit në punësim fitimprurës ose jo, studim apo aktivitete të tjera të paguara.

Neni 2

1. Shtetasit e njërës Palë Kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit, të punësuar me misionet diplomatike dhe konsullore, dhe organizata ndërkombëtare që kanë selinë e tyre në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, kanë të drejtë të hyjnë në territorin e vendit të Palës tjetër pa vizë.

2. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohen edhe për anëtarët e familjeve të tyre që banojnë me ta në të njëjtën familje dhe janë mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit.

Neni 3

Shtetasit e Palës Kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit, do të hyjnë, largohen ose kalojnë transit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese në çdo pikë të kalimit kufitar, të caktuar për trafikun ndërkombëtar.

Neni 4

1. Shtetasit e një Pale Kontraktuese, mbajtës të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit do të veprojnë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e tjera të Palës tjetër Kontraktuese gjatë qëndrimit në territorin asaj Pale.

2. Kjo Marrëveshje nuk do të kufizojë të drejtën e Palëve Kontraktuese për të refuzuar hyrjen ose për të anuluar qëndrimin e një shtetasi të Palës tjetër të cilin ajo mund ta konsiderojë një person të padëshiruar *non grata*.

Neni 5

1. Me qëllim mbrojtjen e sigurisë kombëtare, rendit dhe qetësisë publike, dhe shëndetin e shtetasve të tyre, Palët Kontraktuese do të kenë të drejtë të pezullojnë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, pjesërisht ose plotësisht.

2. Palët Kontraktuese do të informojnë menjëherë njëra-tjetrën për vendimin për pezullim të kësaj Marrëveshjeje, pjesërisht ose plotësisht, ose për rihyrjen e saj në fuqi nëpërmjet kanaleve diplomatike.

3. Pezullimi i zbatimit të kësaj Marrëveshjeje në mënyrë të pjesshme apo të plotë nuk do të ndikojë te të drejtat e shtetasve, të përmendura në nenet 1 dhe 2 të kësaj Marrëveshjeje, të cilat janë tashmë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese

Neni 6

1. Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë specimene të pasaportave të tyre përkatëse, të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Palët Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën për ndryshimin e këtyre mostrave 60 (gjashtëdhjetë) ditë para se ndryshimi të hyjë në fuqi.

3. Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë specimene të pasaportave të reja ose të pasaportave të ndryshuara diplomatike dhe të shërimit, duke përfshirë të dhëna për sa i përket përdorimit të tyre të paktën 60 ditë para se ekzemplarët të jenë prezantuar.

Neni 7

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen miqësisht nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 8

Kjo Marrëveshje lidhet për një afat të pacaktuar. Secila Palë Kontraktuese mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në çdo kohë, duke i dhënë njoftim me shkrim Palëve të tjera Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike. Marrëveshja do të pushojë së zbatuari 90 ditë nga data e marrjes së këtij njoftimi nga Pala tjetër.

Neni 9

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve, në formën e protokolleve shtesë të shkëmbyera me anë të notave diplomatike, të cilat duhet të konsiderohen pjesë përbërëse të kësaj Marrëveshjeje. Ndryshime të tilla ose rishikimi do të hyjë në fuqi në përputhje me dispozitat e nenit 10.

Neni 10

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit diplomatik, me të cilin Palët Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën se të gjitha kushtet e parashikuara nga ligjet e tyre kombëtare për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, janë plotësuar.

Bërë në Nju-Jork, më 26 shtator 2015, në dy origjinalë, në gjuhën shqipe, arabe dhe angleze, të gjitha njëloj autentike. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

